



Datë: 07.04.2025

Numër protokolli: 3001/2025

A.nr.342/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.342/2025, të datës 20.02.2025, të parashtruar nga ankuesit A.M., A.F., A.R., A.Gj., A.H., E.T., E.S., M.M.H., G.L., Sh.E., F.Z., E.B., L.Z.U., Sh.B., R.A. dhe N.K.M., të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat Ardian Megjani nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Autoriteti i Konkurrencës, në çështjen juridiko-administrative “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin16, paragrafi, 3 dhe nenin18, paragrafi 1, nën paragrafin, 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejaur ankesa me numër A.nr.342/2025, e datës 20.02.2025, e parashtruar nga ankuesit A.M., A.F., A.R., A.Gj., A.H., E.T., E.S., M.M.H., G.L., Sh.E., F.Z., E.B., L.Z.U., Sh.B., R.A. dhe N.K.M.

A r s y e t i m

Ankuesit, përmes përfaqësuesit të tyre më autorizim, më 18.02.2025 (përmes postës), kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 20.02.2025, për shkak të mos kompensimit nga punëdhënësi/Autoriteti Kosovar i Konkurrencës se pagesës së rrezikshmërisë dhe atë nga janar 2024 e tutje, në vlerë prej 205 Euro për muaj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.02.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 28.02.2025 dhe 14.03.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesve, ***është e palejuar, sepse:***

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesit sipas akt emërimeve kanë statusin e nëpunësit civil, që të gjithë të punësuar në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës. Të njëjtit më datë 10.01.2025, kanë parashtruar ankesë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, përmes të cilës kanë kërkuar pagesën e rrezikshmërisë dhe kompensimin retroaktiv nga muaji shkuar 2024 e tutje, mirëpo, sipas provave të lëndës nuk kanë pranuar përgjigje lidhur me ankesën.

Ankuesit në ankesën e parashtruar më datë 20.02.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se kanë pas të miratuar shtesën e rrezikshmërisë në vlerën prej 205 Euro, ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, këto shtesa janë ndaluar dhe se nuk e realizojnë të njëjtën. Me tej, ankuesit ankesën e arsyetoj mbi faktin se sipas Aktgjykimit në rastin KO79/23 të Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2 i nenit 45 të këtij ligji, rrjedhimisht me shpalljen të pavlefshme të këtij paragrafi janë lënë në fuqi shtresat e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kërkojnë që ankesa të aprovet si e bazuar, të obligohet Autoriteti i Konkurrencës të bëjë kompensimin e rrezikshmërisë në vlerë 205 Euro në muaj, si dhe të bej kompensimin në mënyrë retroaktive prej muajit shkuar 2024 deri në nxjerrjen e vendimit për ankuesit veç e veç.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushemrisë së ankesës ju referua nenit 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar: *“3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil”*, si dhe nenit 124 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin parashihet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim,..”* dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor rezulton fakti së nëpunësi civil në çdo rast kur pretendon së me veprimin apo mos veprimin e organit përkatës i janë shkelura apo cenuar të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, i njëjti posedon të drejtën e parashtrimit të ankesës në Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si organ i vetëm kompetent për shqyrtimin e ankesave, mirëpo, duke qenë së ankuesit pretendojnë në një të drejtë të natyrës materiale, atëherë, të njëjtit duhet që fillimisht të parashtrajnë kërkesë pranë institucionit punëdhënës, e me pastaj të ushtrojnë ankesë ndaj veprimit(akti administrativ) apo mos veprimit (heshtjes) të organit përkatës, në pajtim me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kuptim të së drejtës në mbrojtje juridike të të drejtave nga marrëdhënia e punës, si një nga të drejtat themelore të garantuara me kushtetutë dhe ligj, Kolegji rithekson faktin së hedhja poshtë e ankesës A.nr.342/2025, nuk nënkupton vendosjen në mënyrë meritore lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve ankimore, pasi që siç u tha me sipër, ankuesit zotërojnë të drejtën që të ndërmarrin verimet për fillimin e procedurës administrative pranë organit punëdhënës, e me pastaj të parashtrajnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyresh për Shërbimin Civil.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë—Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.342/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Ardian Megjani;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.